

### *Nga sesioni i 64 i Komitetit CEDAW*

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare mori pjesë në sesionin e 64 të Komitetit CEDAW, në të cilin u shqyrtua raporti i Katërt Periodik Kombëtar i shtetit shqiptar.

Në datën 11 Korrik 2016, përfaqësuesit e Qendrës së bashku me përfaqësues të NGO-ve të tjera paraqitën para anëtarëve të Komitetit CEDAW çështjet kryesore të raportit hije që kishin përgatitur mbi të drejtat e pronësisë në këndvështrimin gjinor dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave për pensionet ushqimore të fëmijëve.

Në sesionin e datës 12 Korrik, shteti shqiptar raportoi për progresin e bërë gjatë periudhës 2010-2014, në zbatim të detyrimeve të Konventës CEDAW.

#### **1. Disa nga çështjet për të cilat u tregua një interes i veçantë nga anëtarët e Komitetit CEDAWë ishin:**

- Masat e marra për gratë që vijnë nga grupe të marginalizuara si LGBT, azilantët, minoritetet e ndryshme, etj.
- Vetëzbatueshmëria e Konventës CEDAW, vendi që Konventa CEDAW zë në raport me legjislacionin e brendshëm.
- Transparenca dhe numri i limituar i përfituesëve të ndihmës juridike falas nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike;
- Nevoja për amendime në legjislacionin për të drejtat pronësore të grave;
- Ndikimi i reformës së decentralizimit dhe reformës në Drejtësi në numrin e ankesave të grave në lidhje me diskriminimin;
- Nevoja për fuqizimin e Mekanizmit të Barazisë Gjinore dhe Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të Dhunës në familje;
- Monitorimi i efekteve të masave të veçanta të përkohshme;
- Rezultatet e fushatave të ndërgjegjësimit për çështje të barazisë gjinore dhe dhunës në familje;
- Roli i OJF-ve në zbatimin e strategjisë së barazisë gjinore;
- Dobishmëria e vërejtjeve të fundit përmbyllëse të Komitetit në lidhje me çrrënjosjen e stereotipeve, masat e marra në lidhje me martesat e detyruara dhe krimet në emër të nderit;
- Më shumë informacion për abortin e detyruar dhe abortin selektiv;
- Aksesin në shërbime të grave rrome dhe grave në zonat rurale;
- Zbatimin nga shteti shqiptar i detyrimeve që burojnë nga Konventa e Stambollit;
- Riviktimizimin i viktimave të dhunës në sistemin e drejtësisë; kritere strikte aplikuar për pranimin e grave në strehëza; nevoja për forcimin e koordinimit të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, nevoja për fuqizimin e mekanizmave ekzistuese të referimit dhe

koordinimit të rasteve të dhunës në familje dhe ngritja e MKR në të gjithë vendin; thyerja e UMM/UM, Kohëzgjatja e UM; të dhëna të segreguara për gratë rome, viktimat e dhunës në familje, gratë me AK përfituese të ndihmës juridike falas me qëllim hartimin e politikave; rritja e ndërjegjësimit të grave për të përdorur të drejtën e tyre për ndihmë juridike falas;

- Monitorimi afatmesëm nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar i strategjive për trafikimin e qenieve njerëzore dhe rezultatet e këtij monitorimi; financimet për këto shërbime që menaxhohen nga OJF-të; përkujdesja për rehabilitimin e viktimave të trafikimit; respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit gjatë procedimit penal dhe gjykimit, lehtësimi i përfitimit të viktimave nga programi i mbrojtjes së dëshmitarëve ishin disa nga çështjet për të cilat anëtarë të Komitetit CEDAW kërkuar më shumë informacion.
- Masa në lidhje me arsimimin e fëmijëve rom, fëmijëve me aftësi të kufizuara, etj. Niveli i informimit të vajzave në lidhje me arsimin profesional.
- Të dhëna për punësimin, numri i grave që punojnë në industrinë e tekstileve dhe këpucëve, situata e pjesëmarrjes së minoriteteve në tregun e punës, papunësia e grave në tregun e punës.
- Pabarazitë në lidhje me aksesin e grave në fushën e shëndetit riprodhues, aborti selektiv, rritja e numrit të rasteve të transmetimit të virusit HIV, përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e legjislacionit në fushën e shëndetit, kujdesi shëndetësor për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, etj.
- Sistemimi i fëmijëve në institucione të përkujdesit shoqëror për shkak të situatës social ekonomike.
- Probleme në lidhje me përfitimin e ndihmës ekonomike në nivel vendor;
- Programet e banesave sociale dhe zbatimi i tyre;
- Masat e marra në lidhje me integrimin e grave në zonat rurale;
- Hapat në lidhje me një projektligj për moshën e tretë;
- Harmonizimi i Kodit Penal në lidhje me krimin e urrejtjes;
- Parashikimet në Kodin Penal në lidhje me bashkëjetesën e detyruar;
- Nevoja për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me detyrimet antidiskriminim;
- Si kanë ndikuar proceset e reformës së decentralizimit dhe reformës ligjore në mundësinë e grave për të paraqitur ankesa në lidhje me diskriminimin për shkak të seksit dhe gjinisë;
- Masat ligjore në lidhje me çrrënjosjen e praktikave të dëmshme në lidhje me dhunën me bazë gjinore;
- Masat konkrete të ndërmarra nga qeveria shqiptare për të siguruar integrimin e barazisë gjinore në politikat rurale;

Në përfundim të këtij sesi, mesazhi që u përcoll ishte se pavarësisht arritjeve mbetet ende për të bërë me qëllim arritjen e barazisë faktike. Kjo kërkon angazhimin e shtetit shqiptar, organizatave jofitimprurëse dhe aktorëve të tjerë që punojnë në fushën e

barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit për shkak të gjinisë.



Foto nga sesioni i 64 i CEDAW, në të cilin u shqyrtua raporti i katërt periodik i shtetit shqiptar, 12 Korrik 2016



Foto nga takimi jo formal i NGO-ve me anëtarë të Komitetit CEDAW më 11 korrik 2016.